FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 126

Tiranë – E premte, 23 shtator 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 68/2022, datë 15.9.2022	Për mosmiratimin e një kandidature për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga Trupa e Pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, sipas ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.....	16051
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 603, datë 14.9.2022	Për kalim fondi Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për mbështetjen e sektorit energjetik, faza II.....	16051
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 608, datë 22.9.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 360, datë 26.4.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave'", të ndryshuar.....	16051
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 609, datë 22.9.2022	Për disa ndryshime në vendimin nr. 310, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor, 'Skelë–Uji i Ftohtë', Bashkia Vlorë", të ndryshuar.....	16052
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 611, datë 22.9.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore", të ndryshuar.....	16053
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 612, datë 22.9.2022	Për disa ndryshime e shtesa në vendimin nr. 285, datë 10.4.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin, funksionimin, si dhe procedurat e nivelin e tarifave të shërbimeve që do të ofrohen nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO)".....	16054
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 614, datë 22.9.2022	Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor privat parauniversitar "Mehmet Akif Ersoy", i cili e zhvillon mësimin edhe në gjuhë të huaj.....	16055

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 615, datë 22.9.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 43, datë 19.1.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2022".....	16056
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 616, datë 22.9.2022	Për disa ndryshime në vendimin nr. 404, datë 20.6.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masës së kritereve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse".....	16058
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 617, datë 22.9.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", të ndryshuar.....	16058
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 22.9.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 480, datë 13.7.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e dhënies së granteve për *startup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve".....	16059
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 171, datë 13.9.2022	Për miratimin e formatit të dokumentit të identifikimit të detarit (pasaportë detari), për shtetasit e huaj/pa shtetësi, për qëllime peshkimi, në Republikën e Shqipërisë.....	16060
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 21, datë 7.5.2022	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	16070
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 22, datë 10.5.2022	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	16070
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 23, datë 14.5.2022	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	16071
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 24, datë 18.5.2022	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	16071

Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 25, datë 19.5.2022	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	16072
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 26, datë 27.5.2022	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	16072
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 27, datë 1.6.2022	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	16073
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 28, datë 8.6.2022	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	16073
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 29, datë 17.6.2022	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	16074
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 30, datë 18.6.2022	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	16075
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 224, datë 6.9.2022	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë "Albpetrol" sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 140, datë 6.9.2017.....	16075
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 225, datë 6.9.2022	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë "Albpetrol" sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 141, datë 6.9.2017.....	16077
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 226, datë 6.9.2022	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Cosmogral" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	16078
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 227, datë 6.9.2022	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Erni Solar" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw.....	16079

Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 18/8, datë 20.9.2022	Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Krijim hapësire rekreative në zonën e liqenit artificial të qytetit Ballsh".....	16080
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 111/9, datë 20.9.2022	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i hapësirave pranë kopshtit në fshatin Fushë, Njësia Administrative Topojë".....	16081
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 237/9, datë 21.9.2022	Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikimi urban i lagjes 'Llukan Prifti"'.....	16082
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 369/8, datë 20.9.2022	Mbi disa përmirësime në projektpreventivin e objektit "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Rikualifikimi i akseve rrugore Unaza Lindore, loti II"'.....	16084
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 586/8, datë 20.9.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 534, datë 22.9.2021, të Këshillit të Ministrave, për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Ndërtim i rrugës Porto-Romano–Durrës, loti 3".....	16086
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 680/5, datë 20.9.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime të vendimit nr. 587, datë 7.9.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Ndërtimi i hidrocentralit Grabova 2' mbi pellghun ujëmbledhës të përroit të Grabovës, degë e lumit të Devollit, në qarkun Elbasan".....	16088

VENDIM
Nr. 68/2022

PËR MOSMIRATIMIN E NJË KANDIDATURE PËR ANËTAR TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË NGA TRUPA E PEDAGOGËVE TË FAKULTETEVE TË DREJTËSISË DHE TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS, SIPAS LIGJIT NR. 115/2016, "PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 149, pika 8, të Kushtetutës dhe të nenit 35, pika 16, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, si dhe të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e kandidaturës së zotit Florian Bjanku për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që ka rezultuar nga hedhja e shortit të parë në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatit për Anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga Trupa e Pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 15.9.2022.

VENDIM
Nr. 603, datë 14.9.2022

PËR KALIM FONDI MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË PËR MBËSHTETJEN E SEKTORIT ENERGJETIK, FAZA II

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në programin 04320, "Mbështetje për energjinë", në llogarinë ekonomike nr. 232, i shtohet fondi 8 000 000 000 (tetë miliardë) lekë, në formën e transferimit në kapital (transhi i dytë nga fondi i miratuar për këtë qëllim në buxhetin e shtetit), për shoqërinë "Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH)" sh.a., me qëllim mbulimin me likuiditet të veprimtarisë operacionale të shoqërisë.

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, përballohet nga zëri "Mbështetje buxhetore për sektorin energjetik", miratuar në buxhetin e vitit 2022.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 608, datë 22.9.2022

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.360, DATË 26.4.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES 'PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE'", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 15, pika 2, e 94, të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat", dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr.162/2020, "Për prokurimin publik", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun I, të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave", bashkëlidhur vendimit nr.360, datë 26.4.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në nenin 4, shkronjat "l", "ll" dhe "m" shfuqizohen.

b) Pas nenit 4 shtohet neni 4/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 4/1
Blerja e përqendruar

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave kryen blerjen e përqendruar për të gjitha autoritetet dhe entet kontraktore për furnizimin me kuti dhe dosje të standardit të përhershëm, përfshirë edhe etiketat e tyre. Procedura e prokurimit kryhet çdo vit për vitin pasardhës, duke marrë parasysh në këtë procedurë edhe shtrirjen gjeografike të vendruajtjes depozituese finale të dokumentacionit arkivor, për të cilin kryhet blerja e përqendruar.

2. Brenda datës 1 shkurt të çdo viti, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave njofton përmes rrugës shkresore dhe/ose elektronike autoritetet dhe entet kontraktore për:

a) standardet kombëtare të miratuara për kutitë dhe dosjet e standardit të përhershëm;

b) çmimin për njësi të llogaritur përmes parashikimeve ligjore, e indeksuar me ndryshimet e mundshme të evidentuara gjatë studimit paraprak të tregut, të kryer prej saj.

3. Brenda datës 1 mars, autoritetet ose entet kontraktore i dërgojnë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave specifikimet teknike, kërkesat sasiore dhe fondin limit. Kërkesat e dërguara pas kësaj date nuk merren parasysh për prokurimin për vitin pasardhës.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave kryen procedurën e prokurimit nga procesi i njoftimit të kontratës deri në nënshkrimin e marrëveshjes kuadër, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

5. Për çdo kontratë të lidhur nga autoritetet dhe entet kontraktore, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave kryen verifikimin paraprak të cilësisë për sa i përket jetëgjatësisë së kutive dhe dosjeve të standardit të përhershëm, sipas udhëzimeve administrative të saj. Autoritetet ose entet kontraktore marrin në dorëzim kutitë dhe dosjet bashkë me dokumentacionin shoqërues të verifikimit paraprak të cilësisë.".

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 609, datë 22.9.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 310, DATË 21.5.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR, 'SKELË–UJI I FTOHTË', BASHKIA VLORË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 310, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

- Të dhënat e numrit rendor 52, në pronësi të bashkëpronarëve: Metushi, Merkaj dhe Rustemaj, në tabelën bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me të dhënat në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vlera shtesë, prej 984 067.2 (nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëdhjetë e shtatë pikë dy) lekësh e kësaj pasurie, përballohet nga buxheti i Bashkisë Vlorë.

3. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Vlorë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 310, DATË 21.5.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR, 'SKELË–UJI I FTOHTË, BASHKIA VLORË"', TË NDRYSHUAR

NR. RENDOR NË VKM-në NR. 310, DATË 21.5.2014, TË NDRYSHUAR	Pronari	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe (m^2)		Çmimi (lek/m^2)		Vlera (lek)			Shënime
				Truall	Ndërtim	Truall	Ndërtim	Truall	Ndërtesë	Banesë	
52	Bashkëpronësi Metushi, Merkaj, Rustemaj	8602	23/99+2-1	75	64.4	10,174.00	47854	763,050	3,081,797.60	3,844,848	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Efekti shtesë për këtë pasuri është 984 067.2 lekë (vlerësimi shtesë për 15.1 m^2 banesë dhe 75 m^2 truall).
VLERA TOTALE										**3,844,847.60**	

Shënime:
Çmimi i apartamenteve është marrë nga ZVRPP Vlorë ku në ZK 8602 është 58,028 lekë/m^2.
Çmimi i truallit në ZK. 8602 është 10174 lekë/m^2.

VENDIM
Nr. 611, datë 22.9.2022

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 656, DATË 31.10.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLAVE, BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 3, të vendimit nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Shfuqizohen emërtesat e mëposhtme:

i. Këshilli i Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore;

ii. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi;

iii. Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm në Fushën e Shërbimit.

b) Shtohet tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Kulturës dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Tabelë

Emërtesa e Bordit/Këshillit/ Komisionit	Numri maksimal i pagesave në një vit	Përbërja		Masa e shpërblimit në lekë	
		Kryetari	Numri i Anëtarëve	Kryetari	Anëtari
Bordi i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit	4	1	14	10.000	10.000
Komisioni për Skemat e Cilësisë	12	1	6	20.000	15.000
Komiteti për Skemat e Tjera të Cilësisë	6	1	10	15.000	10.000
Bordi Drejtues i Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë	12	1	10	15.000	15.000
Komisioni Disiplinor për Ndërmjetësit e Pasurive të Paluajtshme	12	1	4	15.000	10.000
Komisioni Qendror i Statusit "Fëmijë në përkujdesje të Republikës"	6	1	6	10.000	5.000
Komiteti i Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore	4	1	6	15.000	15.000
Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm për Profesionistët e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror	4	1	7	10.000	10.000
Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm për Profesionistët Shëndetësorë	4	1	9	10.000	10.000
Bordi i Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore	6	1	4	20.000	15.000
Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet	12	1	7	10.000	10.000
Bordi i Akreditimit të Muzeve	4		5		10.000

VENDIM
Nr. 612, datë 22.9.2022

PËR DISA NDRYSHIME E SHTESA NË VENDIMIN NR. 285, DATË 10.4.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, SI DHE PROCEDURAT E NIVELIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE QË DO TË OFROHEN NGA AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KONCESIONEVE (ATRAKO)"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 12, të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun III, "Organizimi dhe funksionimi i ATRAKO-s", të vendimit nr. 285, datë 10.4.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

a) Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"8. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të ATRAKO-s rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.".

b) Pas pikës 8 shtohen pikat 8/1, 8/2 dhe 8/3, me këtë përmbajtje:

"8/1. Kryetari i ATRAKO-s emërohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë. Kryetari i ATRAKO-s duhet të plotësojë kriteret, si më poshtë vijon:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të ketë diplomë të nivelit "Master i shkencave" apo "Master profesional", të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 (njëqind e njëzet) kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vjet akademikë" ose të barasvlershme me to, sipas legjislacionit për arsimin e lartë për shkencat ekonomike/juridike;

ç) të ketë përvojë në profesion, të paktën 3 (tre) vjet;

d) të shquhet për figurë të pastër etiko-morale;

dh) të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;

e) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;

ë) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

f) të mos ketë konflikt interesi me detyrën, në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesave.

8/2. Kryetari i ATRAKO-s lirohet nga detyra, kur:

a) plotëson moshën për pensionin e plotë të pleqërisë;

b) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor;

c) gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit;

ç) jep dorëheqjen nga detyra.

8/3. Kryetari i ATRAKO-s shkarkohet nga detyra, kur:

a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo të një kundërvajtjeje penale me dashje;

b) konstatohen shkelje të dispozitave të legjislacionit në fuqi, përfshirë legjislacionin specifik mbi të cilën ushtron veprimtarinë e ATRAKO-s;

c) kryen veprimtari që krijon konflikt interesash;

ç) konstatohet në kushtet e ndalimit për kryerjen e funksioneve publike, sipas legjislacionit për integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike;

d) kryen shkelje të rënda gjatë kryerjes së detyrës;

dh) vërtetohet se ka përgjegjësi për mosrealizimin e objektivave të vendosur për ATRAKO-n.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 614, datë 22.9.2022

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT PARAUNIVERSITAR "MEHMET AKIF ERSOY", I CILI E ZHVILLON MËSIMIN EDHE NË GJUHË TË HUAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 42 e 70, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor privat parauniversitar "Mehmet Akif Ersoy", i licencuar me vendimin nr. 560, datë 26.8.1996, të Këshillit të Ministrave, "Për dhënie lejeje për funksionimin e institucioneve arsimore private", për nivelin e arsimit të mesëm të lartë, i cili e zhvillon mësimin edhe në gjuhë të huaj.

2. Institucioni arsimor privat parauniversitar "Mehmet Akif Ersoy" ka këto detyrime:

a) të pajisë çdo nxënës me dokumentacionin e nevojshëm shkollor, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar;

b) të mbulojë të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij vendimi;

c) të kthejë pagesat e kryera (nëse ka) nga prindi/përfaqësuesi ligjor i nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbushur që mund të ketë ndaj nxënësit;

ç) të vërë në dispozicion të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë vendim;

d) të dorëzojë në Arkivin Shtetëror Vendor të gjithë dokumentacionin që disponon, si dhe të paraqesë në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, një kopje të dokumentacionit dhe të procesverbalit të dorëzimit të tij, sipas afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

3. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit ndodhet shkolla, ka për detyrë:

a) të ngrejë grup pune brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor privat parauniversitar "Mehmet Akif Ersoy";

b) të marrë masat për transferimin e nxënësve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar për të gjithë nxënësit e regjistruar në këtë institucion arsimor;

c) të administrojë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga ky institucion arsimor privat parauniversitar.

4. Në shkronjën "b", të pikës 1, të vendimit nr. 560, datë 26.8.1996, të Këshillit të Ministrave, "Për dhënie leje për funksionimin e institucioneve arsimore private", fjalët "... kolegji "Mehmet Akif Ersoy", i nivelit të arsimit të mesëm në qytetin e Tiranës...", shfuqizohet.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Durrës, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë, institucioni arsimor privat parauniversitar "Mehmet Akif Ersoy" dhe fondacioni "Gulistan" për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 615, datë 22.9.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 43, DATË 19.1.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE SPITALORE NGA SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PËR VITIN 2022"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtojca nr. 2, bashkëlidhur vendimit nr. 43, datë 19.1.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me shtojcën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për spitalet, për vitin 2022.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

SHTOJCË NR. 2
BUXHETI PËR SHËRBIMIN SPITALOR

000 leke

INSTITUCIONET	BUXHETI NË 000 LEKË SIPAS ARTIKUJVE						
	ART.600	ART.601	ART.602	ART.602 PPP LABORATORË	ART.604	REZERVE	tot
BERAT	295,200	48,500	170,000	59,866			573,566
BULQIZË	81,000	13,200	30,000	0			124,200
DELVINË	37,000	5,800	6,500	0			49,300
DEVOLL	55,500	8,800	15,120	0			79,420
DIBËR	280,000	45,500	120,974	14,647			461,121
ELBASAN	460,000	75,300	252,000	89,131			876,431
FIER	413,000	64,250	204,750	121,011			803,011
GRAMSH	141,000	20,700	44,500	0			206,200
GJIROKASTËR	219,000	36,000	105,980	30,000			390,980
HAS	49,000	7,900	16,000	0			72,900
KAVAJË	124,000	20,000	30,000	0			174,000
KOLONJË	88,000	13,600	20,000	0			121,600
KORÇË	427,000	70,120	277,750	82,017			856,887
KRUJË	132,000	21,000	33,500	0			186,500
KUÇOVË	72,000	10,600	16,000	0			98,600
KUKËS	295,000	45,200	110,000	8,800			459,000
KURBIN	91,000	14,820	35,990	0			141,810
LEZHË	276,000	44,900	132,000	55,977			508,877
LIBRAZHD	160,000	25,900	51,000	0			236,900
LUSHNJË	232,000	37,500	100,000	40,461			409,961
MALËSI E MADHE	24,500	4,000	6,966	0			35,466
MALLAKASTËR	46,000	7,550	13,000	0			66,550
MAT	135,500	22,500	34,000	0			192,000
MIRDITË	114,000	17,900	27,000	0			158,900
PEQIN	40,500	6,350	7,500	0			54,350
PËRMET	84,500	13,700	35,000	0			133,200
POGRADEC	171,500	27,900	77,000	0			276,400
PUKË	96,100	15,040	42,000	0			153,140
SARANDË	158,000	25,400	130,000	26,492			339,892
SKRAPAR	85,000	14,300	18,900	0			118,200
SHKODËR	561,000	91,850	305,000	65,089			1,022,939
TEPELENË	100,000	14,700	16,000	0			130,700
QSUT	2,873,286	426,392	4,410,132	764,638			8,474,448
SUOGJ "MBRETËRESHA GERA	325,000	48,200	250,000	18,631			641,831
SUOGJ "KOÇO GLIOZHENI"	252,000	40,800	260,000	20,185			572,985
SU "SHEFQET NDROQI"	409,500	64,150	525,000	72,434			1,071,084
SU TRAUMA	143,000	22,500	300,000	45,957			511,457
TROPOJË	116,000	18,500	39,500	0			174,000
VLORË	431,100	70,050	344,750	50,000			895,900
"MEMORIAL" FIER				0	1,017,100		1,017,100
DURRËS				73,666	1,089,000		1,162,666
Paketat e shërbimeve					1,716,020		1,716,020
Transferta për individët (mjekë specialistë)					20,000		20,000
Trajtime me VKM					30,000		30,000
Pagesat e shërbimeve PPP					2,535,000		2,535,000
Rezervë					0	1,130,368	1,130,368
	10,094,186	**1,581,372**	**8,613,812**	**1,639,002**	**6,407,120**	**1,130,368**	**29,465,860**

VENDIM
Nr. 616, datë 22.9.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 404, DATË 20.6.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË KRITEREVE E TË PROCEDURAVE TË PËRFITIMIT TË KOMPENSIMIT FINANCIAR, NGA PERSONAT ME STATUSIN E TË VERBRIT DHE INVALIDIT, PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK, PËR FATURËN E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE FATURËN E TELEFONISË FIKSE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 12, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, dhe të nenit 12, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 404, datë 20.6.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikat 1 dhe 2, fjalët "... 2 000 (dy mijë) lekë në muaj..." zëvendësohen me "..... 3 000 (tre mijë) lekë në muaj...".

2. Në pikën 3 të vendimit fjalët "... 1 400 (një mijë e katërqind) lekë në muaj ..." zëvendësohen me "... 2 400 (dy mijë e katërqind) lekë në muaj ...".

3. Kudo në vendim, emërtimet "Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta" dhe "Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta" zëvendësohen, përkatësisht, me "Ministri përgjegjës për çështjet sociale" dhe "Ministria përgjegjëse për çështjet sociale".

4. Ngarkohen Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 tetor 2022 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 617, datë 22.9.2022

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 597, DATË 4.9.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËS MUJORE TË PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE DHE PËRDORIMIT TË FONDIT SHTESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR PËR NDIHMËN EKONOMIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, pikat 1 e 8, e 21, të ligjit nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun III, të vendimit nr. 597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikat 7, 8 dhe 9, fjalët "... 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj ..." zëvendësohen me "... 9 900 (nëntë mijë e nëntëqind) lekë në muaj ...".

b) Pas pikës 16 shtohen pikat 16/1, 16/2 dhe 16/3, me këtë përmbajtje:

"16/1. Gratë kryefamiljare, përfituese në programin e ndihmës ekonomike, që kanë në përbërje të familjes deri në dy fëmijë të moshës nga 0 në 18 vjeç, përfitojnë dyfishin e masës së pagesës ekzistuese të ndihmës ekonomike, sipas strukturës së familjes.

16/2. Përfituesit e programit të ndihmës ekonomike, që kanë mbushur moshën 65 vjeç, të vetmuar, dhe nuk trajtohen me pension pleqërie apo pension social, përfitojnë dyfishin e masës së pagesës ekzistuese të ndihmës ekonomike.

16/3. Anëtarët e familjeve përfituese të programit të ndihmës ekonomike, që kanë mbushur moshën 65 vjeç dhe nuk trajtohen me pension pleqërie apo pension social, përfitojnë dyfishin e masës së pagesës ekzistuese të ndihmës ekonomike, sipas strukturës së familjes.".

c) Pikat 17 dhe 18 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"17. Masa e ndihmës ekonomike për familjet, që nuk përfitojnë sipas pikave 16/1, 16/2 dhe 16/3, të këtij kreu, rritet me dhjetë për qind më shumë të masës së pagesës ekzistuese, sipas strukturës së familjes.

18. Masa e ndihmës ekonomike sipas pikave 16, 16/1, 16/2, 16/3 dhe 17, të këtij kreu, përllogaritet nga Shërbimi Social Shtetëror, bazuar në masën e pagesës ekzistuese, sipas strukturës së familjes, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi.".

2. Ngarkohen Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 tetor 2022 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 618, datë 22.9.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 480, DATË 13.7.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË GRANTEVE PËR *STARTUP*-ET DHE LEHTËSUESIT E *STARTUP*-EVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 14, të ligjit nr. 25/2022, "Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve", me propozimin e ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtojca 1, referuar në pikën 1, të vendimit nr. 480, datë 13.7.2022, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

SHTOJCA 1

FITUESIT *STARTUP*					
Nr.	**Emri i fituesit**	**Individ/ person fizik/person puridik**	**Numri i identifikimit/NIPT**	**Numri i pasaportës *startup***	**Vlera e financimit të miratuar (në lek)**
1	MELIHA ZYBERAJ	Person fizik	L96818007S	S0106	2,145,280
2	DIGITSAPIENS sh.p.k.	Person juridik	M01628007V	S0245	4,000,000
3	INOTECALBANIA sh.p.k.	Person juridik	L93730403P	S0711	3,749,400
4	SKAITECH sh.p.k.	Person juridik	M02209004H	S0153	4,925,000
5	KAMELA HASKO	Person fizik	M11305001L	S0611	5,000,000
6	LEKO TECH sh.p.k.	Person juridik	L82107028B	S0210	2,793,168
7	LIST ALBANIA sh.p.k.	Person juridik	M21731013Q	S0511	2,927,200
8	XHULIA KURTI	Individ	K15223052J	S0188	3,888,000
9	3 D SKAI sh.p.k.	Person juridik	M21727023D	S0417	2,952,857
10	SPONTAN CREATIVE MEDIA sh.p.k.	Person juridik	L82322017V	S0208	4,990,000
11	XOEN sh.p.k.	Person juridik	L91910502H	S0089	5,000,000
12	TERENC PEPA	Individ	I71008081G	S0789	1,154,000
13	AKADEMIA E DRONEVE DHE SISTEMEVE UAS – ALBADRON sh.p.k.	Person juridik	M11328007N	S0461	5,000,000
14	LACONICS sh.p.k.	Person juridik	M02325002F	S0149	5,000,000
15	CUT-CLO sh.p.k.	Person juridik	M21801034G	S0778	2,999,200
16	ERI KOKALARI	Person fizik	L72230015S	S0610	4,625,000
17	CITRUS GROUP sh.p.k.	Person juridik	L77220205G	S0746	4,650,000

18	E-AUDIOSAFETY-ALBANIA sh.p.k.	Person juridik	M21704036L	S0339	2,997,600
19	HMS sh.p.k.	Person juridik	M01819013D	S0203	4,580,000
20	ESIG.AL sh.p.k.	Person juridik	L81420010C	S0326	2,622,070
21	XHOANA KRISTO	Individ	J55816078L	S0046	1,185,000
22	A.L.S CONSULTING sh.p.k.	Person juridik	M02403019H	S0509	3,317,600
23	VALUE PROVIDER sh.p.k.	Person juridik	M12406047F	L0036 *(startup* me pasaportë lehtësuesi)	2,520,000
24	e-FRUTZA sh.p.k	Person juridik	M21730027E	S0497	3'000'000
25	OPENPAY sh.p.k	Person juridik	M21802045D	S0657	2'000'000
26	Akademi.al sh.p.k	Person juridik	L92116025A	S0390	4'996'966
27	Dupron sh.p.k	Person juridik	M02124006D	S0340	4'997'920
28	Wolf Technologies sh.p.k	Person juridik	M21622007Q	S0685	2'966'400
29	RPay sh.p.k	Person juridik	M11328018F	S0500	5'000'000

FITUESIT LEHTËSUES TË *STARTUP*-EVE

Nr.	Emri i fituesit	OJF/Person fizik/person juridik/ent publik	NIPT	Numri i pasaportës lehtësues	Vlera e financimit të miratuar (në lek)
1	BARLETI GROUP sh.p.k.	Person juridik	K52115006H	L0046	7,000,000
2	BASHKIA KORÇË	Ent publik	K54105075C	L0108	19,999,008
3	AULEDA	OJF	K56524212N	L0028	1,000,000
4	BASHKIA DIMAL	Ent publik	K52917023I	L0080	8,000,000
5	BASHKIA BULQIZË	Ent publik	K46915401W	L0172	2,321,549
6	BASHKIA PUKË	Ent publik	K58811318P	L0170	2,458,000
7	JUNIOR ACHIEVEMENT OF ALBANIA	OJF	L31311451J	L0203	5,880,947
8	PAMELA GRUDA	Person fizik	M12109030R	L0208	4,000,000
9	BASHKIA SHKODËR	Ent publik	K36813001H	L0142	7,000,000
10	BASHKIA MALËSI E MADHE	Ent publik	K48420701I	L0094	15,369,369
11	LIFE sh.p.k.	Person juridik	L41629010D	L0175	3,000,000
12	TIRANA BUSINESS UNIVERSITY sh.p.k.	Person juridik	L01801024T	L0096	3,000,000
13	BLERI DERVISHI	Person fizik	L91904024A	L0115	9,977,600
14	BASHKIA ROSKOVEC	Ent publik	K52905407N	L0194	3,000,000
15	ALBANA MUÇAJ	Person fizik	L61712031O	L0131	3,000,000
16	UNIQUE JUNIOR ENTERPRISE	OJF	L31724451R	L0136	2,000,000
17	FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS, UNIVERSITETI I TIRANËS	Ent Publik	K51713059D	L0235	9,184,200
18	QENDRA BALANCE	OJF	M11315451H	L0051	9,800,000
19	QENDRA METAVERSE	OJF	M21509456N	L0193	5,000,000
20	SHKOLLA TEKNIKE ELEKTRIKE	Ent Publik	K51717012I	L0030	5,215,200
21	UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS	Ent Publik	J61915028N	L0098	5,000,000
22	ICTS MEDIA sh.p.k.	Person juridik	L21624006R	L0114	9,711,200
23	KOESTINGER & PARTNERS - INNOVATION SUSTAINABILITY sh.p.k.	Person juridik	M21402059H	L0068	5,000,000
24	QENDRA PROTIK	OJF	L22010451T	L0020	3,000,000
25	SHOQATA KS FACTOR	OJF	M01502451T	L0087	4,000,000
26	NEW MEDIA DIGITAL sh.p.k.	Person juridik	L71705007H	L0054	3,000,000
27	FONDACIONI DRITAN HOXHA	OJF	L11321451L	L0097	8,000,000
28	QENDRA KËRKIMORE PËR RRITJE EKONOMIKE DHE QEVERISJE	OJF	M12323451D	L0055	5,000,000
29	DESTIL CREATIVE HUB	OJF	M21418452F	L0110	9,000,000

URDHËR
Nr. 171, datë 13.9.2022

PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË DOKUMENTIT TË IDENTIFIKIMIT TË DETARIT (PASAPORTË DETARI), PËR SHTETASIT E HUAJ/PA SHTETËSI, PËR QËLLIME PESHKIMI, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në bazë të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të shkronjës "b", të nenit 401, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; të nenit 3, të udhëzimit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 16, datë 20.7.2022, "Për rregullat dhe procedurat për lëshimin e dokumentit të identifikimit të detarit 'Pasaportë Detari', për shtetasit e huaj/pa shtetësi, për qëllime peshkimi, në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Miratimin e formatit të dokumentit të identifikimit të detarit "Pasaportë Detari", për shtetasit e huaj/pa shtetësi, për qëllime peshkimi, në Republikën e Shqipërisë, për shërbimet e ofruara nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Detare për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

LIDHJA NR. 1
FORMATI I DOKUMENTIT TË IDENTIFIKIMIT TË DETARIT "PASAPORTË DETARI", PËR SHTETASIT E HUAJ/PA SHTETËSI, PËR QËLLIME PESHKIMI, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, PËR SHËRBIMET E OFRUARA NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

KAPAKU I DOKUMENTIT DO JETE NGJYRE KAFE



Fq.1 Fillon me Nr. Serie: **000001**

Fq. 2 & Fq. 3


Faqe e rezervuar për fotografinë e mbajtësit të pasaportës
Page reserved for the photograph of the holder of the seaman's book
Lëshuar me
Issued on
E vlefshme deri
valid up to
PERSONI I AUTORIZUAR
AUTHORIZED PERSON
Firma dhe vula zyrtare
Signature & official seal
2
DREJTORIA E PERGJITHSHME DETARE
General Maritime Directorate
PASAPORTE E DETARIT
SEAMAN'S BOOK
e detarit
of the seafarer
Lindur më
date of birth
qyteti
city
numri i pasaportës
passport number
kombësia
citizenship
regjistruar në regjistrin e detarëve në
entered in the registers of seafarers at
me cilësinë e
in capacity of
me numër
number
SHENJA TE VEÇANTA
Personal descriptions
gjatësia
height
syte
color of eyes
grupi i gjakut
blood group
shenja të veçanta
distinguishing marks
Personi i autorizuar
Authorized Person
3

Fq. 4 & Fq. 5


Titujt profesional si dhe kualifikimet e tjera të detarit
Professional titles and subsequend qualifications of the seafarer
Shënime të tjera
Other Notes
4
5

Fq. 6 & Fq. 7 & Fq. 8 & Fq. 9 Fq. 10 & Fq. 11



Fq. 20 e dokumentit ekzistues do korespondoje me fq.12 te dokumentit propozuar

12

Fq. 13 & 14 do vijoje 15 & 16, 17 & 18, 19 & 20, 21 & 22, 23 & 24, 25 & 26, 27 & 28, 29 & 30, 31 & 32, 33 & 34, 35 & 36, 37 & 38, 39 & 40, 41 & 42, 43 & 44, 45 & 46, 47 & 48, 49 & 50, 51 & 52, 53 & 54

UDHËZIM

1. Pasaporta e Detarit është një dokument zyrtar, që lëshohet nga personi i autorizuar, në bazë të rregullave përkatëse dhe shërben për të vërtetuar shtetësinë, identitetin dhe kualifikimin teknik të detarit.
2. Me këtë dokument paisen vetëm detarët me shtetësi të huaj apo pa shtetësi të cilët janë të paisur me një leje unike (qëndrimi) të lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë dhe që do të punojnë në anije për qëllime peshkimi në Republikën e Shqipërisë.
3. Lëshimi dhe zgjatja e afatit të kësaj pasaporte, në të gjitha rastet, bëhet në përputhshmëri me afatin e lejes unike (të qëndrimit) të lëshuar prej nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.
4. Ky dokument lëshohet në këmbim të dorëzimit të dokumentit ekzistues që detari mban nga autoritetet e shtetit nga vjen.
5. Ky dokument dorëzohet në zyrën që e ka lëshuar në se zotëruesi i saj tërhiqet nga puna në anije dhe në këtë rast dokumenti i ruajtur sipas pikës 4. i kthehet zotëruesit.
6. Ky dokument shërben për të kryer procedurat e imbarkimit dhe zbarkimit në anije sipas rregullave të vendosura.
7. Ky dokument nuk është i vlefshëm për imbarkim në një anije peshkimi e cila do të lundrojë nga një port shqiptar drejt një porti të huaj.

55

INSTRUCTION

1. The Seafarer's Passport is an official document, which is issued by the authorized person, based on the relevant rules, and serves to prove the citizenship, identity and technical qualification of the seafarer.
2. This document applies only to seafarers with foreign or stateless citizenship who are equipped with a unique (residence) permit issued by the competent authorities in the Republic of Albania and who will work on ships for fishing purposes in the Republic of Albania.
3. Issuing and extending the term of this passport, in all cases, is done in compliance with the term of the unique (residence) permit issued/extended by the competent authorities in the Republic of Albania.
4. This document is issued in exchange for the submission of the existing document that the seafarer holds from the authorities of the country from which he comes.
5. This document is submitted to the office that issued it if its owner withdraws from work on the ship, and in this case the document saved according to point 4, is returned to the owner.
6. This document serves to carry out the boarding and disembarking procedures on the ship according to the established rules.
7. This document is not valid for boarding a fishing vessel which will sail from an Albanian port to a foreign port.

56

Fq. 55 & 56 mbyllin rubrikat e dokumentit me udhezimin ne Shqip & Anglisht

57

Fq. 57 Kapaku

VENDIM
Nr. 21, datë 7.5.2022

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të çmimeve të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit, në mbështetje të nenit 21/3, të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022 si dhe nenit 21/5, të aktit normativ nr. 8, datë 25.3.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre"', të ndryshuar;

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë të produkteve, si më poshtë:
- 225 lekë/litri për gazoilin;
- 215 lekë/litri për benzinën;
- 88 lekë/litri për gazit të lëngshëm të naftës.

2. Miratimin e çmimit tavan të tregtimit me pakicë të produkteve, si më poshtë:
- 237 lekë/litri për gazoilin;
- 227 lekë/litri për benzinën;
- 100 lekë/litri për gazit të lëngshëm të naftës.

3. Efektet e këtij vendimi fillojnë sot datë 7.5.2022, ora 18:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës.

4. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, në zbatim të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022 dhe nr. 8, datë 25.3.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre"', të ndryshuar.

5. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Belinda Balluku, Ceno Klosi, Genti Gazheli, Niko Lera, Ilia Gjermani, Enea Karakaçi, Sezar Beqaj, Artur Llogoni, Gerian Kuqi, Agron Bulku, Saimir Krasniqi

VENDIM
Nr. 22, datë 10.5.2022

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të çmimeve të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit, në mbështetje të nenit 21/3 të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, si dhe nenit 21/5, të aktit normativ nr. 8, datë 25.3.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre"', të ndryshuar;

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë të produkteve, si më poshtë:
- 220 lekë/litri për gazoilin;
- 212 lekë/litri për benzinën;
- 88 lekë/litri për gazit të lëngshëm të naftës.

2. Miratimin e çmimit tavan të tregtimit me pakicë të produkteve, si më poshtë:
- 232 lekë/litri për gazoilin;
- 224 lekë/litri për benzinën;
- 100 lekë/litri për gazit të lëngshëm të naftës.

3. Efektet e këtij vendimi fillojnë sot datë 10.5.2022, ora 18:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës.

4. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, në zbatim të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022 dhe nr. 8, datë 25.3.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar.

5. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Belinda Balluku, Ceno Klosi, Genti Gazheli, Niko Lera, Ilia Gjermani, Enea Karakaçi, Sezar Beqaj, Artur Llogoni, Gerian Kuqi, Agron Bulku, Saimir Krasniqi

VENDIM
Nr. 23, datë 14.5.2022

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të çmimeve të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit, në mbështetje të nenit 21/3, të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, si dhe nenit 21/5, të aktit normativ nr. 8, datë 25.3.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8450, datë 24.2.1999 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre"', të ndryshuar;

VENDOSI

1. Miratimin e çmimit tavan (maksimal) të tregtimit me shumicë të produkteve, si më poshtë:
- 225 lekë/litri për gazoilin;
- 222 lekë/litri për benzinën;
- 78 lekë/litri për gazit të lëngshëm të naftës.

2. Miratimin e çmimit tavan (maksimal) të tregtimit me pakicë të produkteve, si më poshtë:
- 237 lekë/litri për gazoilin;
- 234 lekë/litri për benzinën;
- 90 lekë/litri për gazit të lëngshëm të naftës.

3. Efektet e këtij vendimi fillojnë datë 15.5.2022, ora 18:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës.

4. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, në zbatim të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022 dhe nr. 8, datë 25.3.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre"', të ndryshuar.

5. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Belinda Balluku, Ceno Klosi, Genti Gazheli, Niko Lera, Ilia Gjermani, Enea Karakaçi, Sezar Beqaj, Artur Llogoni, Gerian Kuqi, Agron Bulku, Saimir Krasniqi, .

VENDIM
Nr. 24, datë 18.5.2022

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të çmimeve të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit, në mbështetje të nenit 21/3 të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, si dhe nenit 21/5, të aktit normativ nr. 8, datë 25.3.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre"', të ndryshuar;

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit tavan (maksimal) të tregtimit me shumicë të produkteve, si më poshtë:
- 222 lekë/litri për gazoilin;
- 225 lekë/litri për benzinën;
- 78 lekë/litri për gazit të lëngshëm të naftës.

2. Miratimin e çmimit tavan (maksimal) të tregtimit me pakicë të produkteve, si më poshtë:
- 234 lekë/litri për gazoilin;
- 237 lekë/litri për benzinën;
- 90 lekë/litri për gazit të lëngshëm të naftës.

3. Efektet e këtij vendimi fillojnë datë 18.5.2022, ora 18:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës.

4. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, në zbatim të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022 dhe nr. 8, datë 25.3.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre"', të ndryshuar.

5. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Belinda Balluku, Ceno Klosi, Genti Gazheli, Niko Lera, Ilia Gjermani, Sezar Beqaj, Enea Karakaçi, Artur Llogoni, Gerian Kuqi, Agron Bulku, Saimir Krasniqi

VENDIM
Nr. 25, datë 19.5.2022

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të çmimeve të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit, në mbështetje të nenit 21/3, të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, si dhe nenit 21/5, të aktit normativ nr. 8, datë 25.3.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8450, datë 24.2.1999 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre"', të ndryshuar;

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit tavan (maksimal) të tregtimit me shumicë të produkteve, si më poshtë:
- 217 lekë/litri për gazoilin;
- 217 lekë/litri për benzinën;
- 78 lekë/litri për gazit të lëngshëm të naftës.

2. Miratimin e çmimit tavan (maksimal) të tregtimit me pakicë të produkteve, si më poshtë:
- 229 lekë/litri për gazoilin;
- 229 lekë/litri për benzinën;
- 90 lekë/litri për gazit të lëngshëm të naftës.

3. Efektet e këtij vendimi fillojnë datë 19.5.2022, ora 18:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës.

4. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, në zbatim të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022 dhe nr. 8, datë 25.3.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8450, datë 24.2.1999 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre"', të ndryshuar.

5. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Belinda Balluku, Ceno Klosi, Genti Gazheli, Niko Lera, Ilia Gjermani, Enea Karakaçi, Sezar Beqaj, Artur Llogoni, Gerian Kuqi, Agron Bulku, Saimir Krasniqi

VENDIM
Nr. 26, datë 27.5.2022

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të çmimeve të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit, në mbështetje të nenit 21/3 të aktit normativ nr. 5, datë 12.03.2022 si dhe nenit 21/5 të aktit normativ nr. 8, datë 25.3.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre"', të ndryshuar;

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit tavan (maksimal) të tregtimit me shumicë të produkteve, si më poshtë:
- 227 lekë/litri për gazoilin;
- 225 lekë/litri për benzinën;
- 78 lekë/litri për gazit të lëngshëm të naftës.

2. Miratimin e çmimit tavan (maksimal) të tregtimit me pakicë të produkteve, si më poshtë:
- 239 lekë/litri për gazoilin;
- 237 lekë/litri për benzinën;
- 90 lekë/litri për gazit të lëngshëm të naftës.

3. Efektet e këtij vendimi fillojnë datë 27.5.2022, ora 18:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës.

4. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, në zbatim të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022 dhe nr. 8, datë 25.3.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre"', të ndryshuar.

5. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Belinda Balluku, Ceno Klosi, Genti Gazheli, Niko Lera, Ilia Gjermani, Enea Karakaçi, Sezar Beqaj, Artur Llogoni, Gerian Kuqi, Agron Bulku, Saimir Krasniqi

VENDIM
Nr. 27, datë 1.6.2022

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë / Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të nenit 21/3, të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, si dhe nenit 21/5, të aktit normativ nr. 8, datë 25.3.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8450, datë 24.2.1999, 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre', të ndryshuar",

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit tavan (max) të tregtimit me shumicë të produkteve, si më poshtë:
- 236 lekë/litri për gazoilin;
- 232 lekë/litri për benzinën;
- 78 lekë/litri për gazin e lëngshëm të naftës.

2. Miratimin e çmimit tavan (max) të tregtimit me pakicë të produkteve, si më poshtë:
- 248 lekë/litri për gazoilin;
- 244 lekë/litri për benzinën;
- 90 lekë/litri për gazin e lëngshëm të naftës.

3. Efektet e këtij vendimi fillojnë në datën 1.6.2022, ora 18:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës.

4. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, në zbatim të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022 dhe nr. 8, datë 25.3.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8450, datë 24.2.1999, 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre', të ndryshuar".

5. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Belinda Balluku, Sezar Beqaj, Ceno Klosi, Genti Gazheli, Niko Lera, Ilia Gjermani, Enea Karakaçi, Artur Llogoni, Gerian Kuqi, Agron Bulku, Saimir Krasniqi

VENDIM
Nr. 28, datë 8.6.2022

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të nenit 21/3, të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, si dhe nenit 21/5, të aktit normativ nr. 8, datë 25.3.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8450, datë 24.2.1999, 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre', të ndryshuar",

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të naftës, për benzinën (prem unl 10 ppm të standardit SSH EN 228 2018), gazoilin (10 ppm ULSD të standardit SSH EN 590 2018) dhe gazin e lëngshëm të naftës (propan/butan). Çmimet e miratuara nga Bordi, të cilat reflektojnë çmimet e nënprodukteve në bursë, të publikuara nga agjencia ndërkombëtare "S&P Global Platts" në USD, detyrimet doganore/tatimore që aplikohen, si dhe marzhet bruto maksimale të tregtimit, (përfshijnë edhe TVSH-në) janë çmime tavan/maksimale dhe asnjë operator ekonomik nuk mund t'i tregtojë këto nënprodukte mbi çmimet tavan të vendimit të Bordit. Çdo operator ekonomik me shumicë dhe pakicë është i lirë t'i tregtojë këto nënprodukte me çmime më të ulëta se çmimet tavan/maksimale të miratuara në Bord:

a) çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë të produkteve, janë si më poshtë:
- 246 lekë/litri për gazoilin 10 ppm ULSD, të standardit SSH EN 590 2018;
- 231 lekë/litri për benzinën prem unl 10 ppm, të standardit SSH EN 228 2018;
- 74 lekë/litri për gazin e lëngshëm të naftës;

b) çmimet tavan/maksimale të tregtimit me pakicë të produkteve, janë si më poshtë:
- 258 lekë/litri për gazoilin 10 ppm ULSD, të standardit SSHEN 590 2018;

- 243 lekë/litri për benzinën prem unl 10 ppm, të standardit SSH EN 228 2018;

- 86 lekë/litri për gazin e lëngshëm të naftës.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë në datën 8.6.2022, ora 18:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës.

3. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, në zbatim të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022 dhe nr. 8, datë 25.3.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8450, datë 24.2.1999, 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre', të ndryshuar".

4. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Belinda Balluku, Sezar Beqaj, Ceno Klosi, Genti Gazheli, Niko Lera, Ilia Gjermani, Enea Karakaçi, Artur Llogoni, Gerian Kuqi, Agron Bulku, Saimir Krasniqi

VENDIM
Nr. 29, datë 17.6.2022

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të nenit 21/3, të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, si dhe nenit 21/5, të aktit normativ nr. 8, datë 25.3.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8450, datë 24.2.1999, 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre', të ndryshuar",

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të naftës, për benzinën (prem unl 10 ppm të standardit SSH EN 228 2018), gazoilin (10 ppm ULSD të standardit SSH EN 590 2018) dhe gazin e lëngshëm të naftës (propan/butan). Çmimet e miratuara nga Bordi, të cilat reflektojnë çmimet e nënprodukteve në bursë, të publikuara nga agjencia ndërkombëtare "S&P Global Platts" në USD, detyrimet doganore/tatimore që aplikohen, si dhe marzhet bruto maksimale të tregtimit, (përfshijnë edhe TVSH-në) janë çmime tavan/maksimale dhe asnjë operator ekonomik nuk mund t'i tregtojë këto nënprodukte mbi çmimet tavan të vendimit të Bordit. Çdo operator ekonomik me shumicë dhe pakicë është i lirë t'i tregtojë këto nënprodukte me çmime më të ulëta se çmimet tavan/maksimale të miratuara në Bord:

a) çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë të produkteve, janë si më poshtë:

-253 lekë/litri për gazoilin 10 ppm ULSD, të standardit SSH EN 590 2018;

-229 lekë/litri për benzinën prem unl 10 ppm, të standardit SSH EN 228 2018;

-74 lekë/litri për gazin e lëngshëm të naftës;

b) çmimet tavan/maksimale të tregtimit me pakicë të produkteve, janë si më poshtë:

-265 lekë/litri për gazoilin 10 ppm ULSD, të standardit SSH EN 590 2018;

-241 lekë/litri për benzinën prem Unl 10 ppm, të standardit SSH EN 228 2018;

-86 lekë/litri për gazin e lëngshëm të naftës.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë në datën 17.6.2022, ora 18.00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës.

3. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, në zbatim të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022 dhe nr. 8, datë 25.3.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8450, datë 24.2.1999, 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre', të ndryshuar".

4. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Belinda Balluku, Sezar Beqaj, Ceno Klosi, Genti Gazheli, Niko Lera, Ilia Gjermani, Enea Karakaçi, Artur Llogoni, Gerian Kuqi, Agron Bulku, Saimir Krasniqi

VENDIM
Nr. 30, datë 18.6.2022

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të nenit 21/3, të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, si dhe nenit 21/5, të aktit normativ nr. 8, datë 25.3.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre', të ndryshuar",

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të naftës, për benzinën (prem unl 10 ppm të standardit SSH EN 228 2018), Gazoilin (10 ppm ULSD të standardit SSH EN 590 2018) dhe gazin e lëngshëm të naftës (propan/butan). Çmimet e miratuara nga Bordi, të cilat reflektojnë çmimet e nënprodukteve në bursë, të publikuara nga agjencia ndërkombëtare "S&P Global Platts" në USD, detyrimet doganore/tatimore që aplikohen, si dhe marzhet bruto maksimale të tregtimit, (përfshijnë edhe TVSH-në) janë çmime tavan/maksimale dhe asnjë operator ekonomik nuk mund t'i tregtojë këto nënprodukte mbi çmimet tavan të vendimit të Bordit. Çdo operator ekonomik me shumicë dhe pakicë, është i lirë t'i tregtojë këto nënprodukte me çmime më të ulëta se çmimet tavan/maksimale të miratuara në Bord:

a) çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë të produkteve, janë si më poshtë:

-249 lekë/litri për gazoilin 10 ppm ULSD, të standardit SSH EN 590 2018;

-224 lekë/litri për benzinën prem unl 10 ppm, të standardit SSH EN 228 2018;

- 74 lekë/litri për gazin e lëngshëm të naftës;

b) çmimet tavan/maksimale të tregtimit me pakicë të produkteve, janë si më poshtë:

-261 lekë/litri për gazoilin 10 ppm ULSD, të standardit SSH EN 590 2018;

-236 lekë/litri për benzinën prem unl 10 ppm, të standardit SSH EN 228 2018;

-86 lekë/litri për gazin e lëngshëm të naftës.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë në datën 18.6.2022, ora 18:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës.

3. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, në zbatim të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022 dhe nr. 8, datë 25.3.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8450, datë 24.2.1999, 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre', të ndryshuar".

4. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Belinda Balluku, Sezar Beqaj, Ceno Klosi, Genti Gazheli, Niko Lera, Ilia Gjermani, Enea Karakaçi, Artur Llogoni, Gerian Kuqi, Agron Bulku, Saimir Krasniqi

VENDIM
Nr. 224, datë 6.9.2022

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "ALBPETROL" SHA, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 140, DATË 6.9.2017

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "e", nenit 5, pika 1, germa "e", nenit 10, pikat 1 dhe 3, si dhe nenit 16 të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; nenit 15 dhe nenit 19, pika 1 germa "a" të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve

dhe Mbikëqyrjes me nr. 1510/2 prot., datë 2.9.2022, "Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë 'Albpetrol' sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 140, datë 6.9.2017",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 180, datë 13.7.2022, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë "Albpetrol" sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE bëri njoftimin në median e shkruar për këtë vendimmarrje, i cili është botuar në datat 15.7.2022 dhe 16.7.2022 dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve të mundshme nga të tretët (data e fundit 28.7.2022), nuk rezulton të ketë të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 971/2 prot., datë 27.7.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën "Njoftim vendimi dhe kërkesë për plotësim dokumentacioni".

- Në vijim të e-mailit të shoqërisë, protokolluar në ERE me nr. 971/2 prot., datë 8.8.2022, me anë të të cilit ka depozituar dokumentacion plotësues sikurse ka deklaruar se do të depozitojë në vijim dhe dokumentacion shtesë për këtë aplikim, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 205, datë 10.8.2022, vendosi të shtyjë deri më 6.9.2022 afatin e vendimmarrjes së tij për rinovimin e licencës së shoqërisë "Albpetrol" sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendimmarrje me shkresën nr. 970/2 prot., datë 22.8.2022, duke evidentuar dhe dokumentacionin e mbetur ende pa plotësuar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 970/3 prot., datë 31.8.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacion/informacion plotësues për aplikimin dhe ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, në zbatim të aneksit A të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik dhe administrativ; dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin në zbatim të nenit 9, pika 1, germat "a", "b" dhe "c", nenit 9, pika 2 germat "a", "b", "c", "d" dhe "e", nenit 9, pika 3 germat "a", "c" dhe "d" si dhe nenit 9, pika 4.8, germat "a", "b" dhe "c".

- Në lidhje me dokumentacionin financiar shoqëria "Albetrol" sh.a., duhet të depozitojë në ERE bilancin financiar të vitit 2021 sikurse depozituar në organet tatimore deri më 31 mars 2022.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 381, seria T17 të shoqërisë "ALBPETROL" sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 140, datë 06.09.2017, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 7.9.2022.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 225, datë 6.9.2022

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "ALBPETROL" SHA, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 141, DATË 6.9.2017

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "ç" të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "d", nenit 5, pika 1, germa "d", dhe nenit 13 të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1510/3 prot., datë 2.9.2022, "Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë "Albpetrol" sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 141, datë 6.9.2017",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 179, datë 13.7.2022, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë "Albpetrol" sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- ERE bëri njoftimin në median e shkruar për këtë vendimmarrje, i cili u botua në datat 15.7.2022 dhe 16.7.2022 dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve të mundshme nga të tretët (data e fundit 28.7.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 971/2 prot., datë 27.7.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën "Njoftim vendimi dhe kërkesë për plotësim dokumentacioni".

- Në vijim të e-mailit të shoqërisë, protokolluar në ERE, me nr. 971/2 prot., datë 8.8.2022, me anë të të cilit ka depozituar dokumentacion plotësues sikurse ka deklaruar se do të depozitojë në vijim dhe dokumentacion shtesë për këtë aplikim, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 204, datë 10.8.2022, vendosi të shtyjë deri më 6.9.2022 afatin e vendimmarrjes për rinovimin e licencës së shoqërisë "Albpetrol" sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendimmarrje me shkresën nr. 970/2 prot., datë 22.8.2022, duke evidentuar dhe dokumentacionin e mbetur ende pa plotësuar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 970/3 prot., datë 31.8.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacion/informacion plotësues për këtë aplikim dhe ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, në zbatim të aneksit A të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" e ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik dhe administrativ; dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin në zbatim të nenit 9, pika 1, germat "a", "b" dhe "c", nenit 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d" dhe "e", nenit 9, pika 3, germat "a", "c" dhe "d", si dhe nenit 9, pika 4.7, germat "a", "b", "c", "d", "f", "g", "h" dhe "i".

- Në lidhje me dokumentacionin financiar shoqëria duhet të depozitojë në ERE bilancin financiar të vitit 2021 sikurse depozituar në organet tatimore deri më 31 mars 2022, si dhe informacion/dokumentacion mbi sistemin IT që përdor për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 382, seria F17, shoqërisë "Albpetrol" sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 141, datë 6.9.2017, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 7.9.2022.

2. Brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e këtij vendimi, shoqëria "Albpetrol" sh.a. duhet të depozitojë në ERE:

a) informacion/dokumentacion mbi sistemin IT që përdor për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike;

3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 226, datë 6.9.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "COSMOGRAL" SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "e", nenit 5, pika 1, germa "e", nenit 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1510 prot., datë 2.9.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë 'Cosmogral' sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Cosmogral" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1498 prot., datë 25.8.2022, ka paraqitur aplikimin për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të aneksit A të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe dokumentacionin teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin në zbatim të nenit 9, pika 1, germat "a" dhe "b", nenit 9, pika 2, germat "a", "b" dhe "e", nenit 9, pika 3, germat "b", "c" dhe "d" si dhe nenit 9, pika 4.8, germat "a", "b" dhe "c".

- Mungesa e dokumentacionit ka të bëjë me:

nenin 9, pika 1, germa "c": Shoqëria duhet të saktësojë deklaratën e saj në lidhje me ushtrimin e aktiviteteve të tjera.

nenin 9, pika 2, germa "c": Shoqërisë duhet të shtojë në objektin e veprimtarisë së saj në QKB edhe veprimtarinë për të cilën kërkon të licencohet.

nenin 9, pika 2, germa "d": Shoqëria duhet të përcjellë në ERE vërtetimet përkatëse të gjykatës dhe prokurorisë, për administratorin dhe vetë shoqërinë.

nenin 9, pika 3, germa "a": Shoqëria duhet të përcjellë në ERE vërtetimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore me detyrimin e shlyer.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Cosmogral" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 227, datë 6.9.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ERNI SOLAR" SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "a", nenit 5, pika 1, germa "a" dhe nenit 10, pika 3 të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të rregullores "Për organizimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1510/4 prot., datë 2.9.2022, "Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë 'ERNI SOLAR' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw",

konstatoi se:

- Shoqëria "Erni Solar" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1429 prot., datë 23.8.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2,2 mw.

- Pavarësisht se shoqëria ka paraqitur kërkesën për t'u licencuar për 2,2 mw, në çdo dokument, miratim apo leje, kapaciteti i përcaktuar është 2 mw, ashtu si dhe në kontratën me MIE-n, ku specifikohet se shoqëria nuk mund të operojë me kapacitet më të madh se 2 mw. Gjithashtu, edhe pagesa që ka bërë subjekti për llogari të ERE-s, në zbatim të përcaktimeve të aneksit A të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar, përkon me kapacitetin 2 mw. Në këto rrethana aplikimi i shoqërisë do të shqyrtohet për kapacitetin e instaluar 2 mw.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal; dokumentacionin teknik për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe lejet nga institucionet respektive. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin në zbatim të nenit 9, pika 1, germat "a" dhe "b", nenit 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "e" dhe "f", nenit 9, pika 3, germat "a" dhe "d", nenit 9, pika 4.4.3, germat "a", "c" dhe "d", nenit 9, pika 4.4.4, germa "b", si dhe nenit 9, pika 4.4.5, germat "a" dhe "b".

- Dokumentacioni i munguar apo i plotësuar pjesërisht është si vijon:

Neni 9, pika 1, germa "c": Shoqëria duhet të plotësojë deklaratën për njohjen me kuadrin ligjor dhe angazhimin për zbatimin e tij.

Neni 9, pika 2, germa "d": Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, si dhe vërtetimin përkatës të Prokurorisë dhe Gjykatës së Rrethit Korçë, për shoqërinë "Erni Solar" sh.p.k.

Neni 9, pika 2, germa "g": Shoqëria duhet të depozitojë sqarimin përkatës të "Erni Solar" sh.p.k. në lidhje me sipërfaqen totale të zonës së projektit, në rast se ka ndonjë gabim të mundshëm në referencat e kësaj prone që do të shfrytëzojë shoqëria për ndërtimin dhe shfrytëzimin e projektit të centralit fotovoltaik. Gjithashtu, shoqëria duhet të depozitojë informacion mbi saktësimin e koordinatave te pronësisë në shkresën e Bashkisë Devoll, në lidhje me referimin që i bëhet numrit të pasurisë së pronës dhe nr. të repertorit të kontratës së qirasë që shoqëria "RTS" sh.p.k. ka lidhur me Bashkinë Devoll.

Neni 9, pika 3, germa "b": Shoqëria duhet të depozitojë në ERE bilancin financiar të vitit 2019, referuar muajve të krijimit të saj.

Neni 9, pika 3, germa "c": Shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka vijuar me nënshkrimin e ndonjë kontrate kredie me bankën për të siguruar investimin për 80% të vlerës që do të investohet nga banka dhe nëse po, ta dokumentojë në ERE me sqarimet përkatëse mbi qëllimin e përdorimit të fondeve të marra hua nga banka. Po ashtu, në zbatim të nenit 8, pika 3, vërtetimi mbi gjendjen e llogarisë bankare duhet të depozitohet i lëshuar jo më herët se 1 muaj përpara paraqitjes së aplikimit, në mënyrë që të përllogaritet nëse shuma përkatëse mbulon 20% të vlerës së mbetur të investimit.

Neni 9, pika 4.4.1: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE të dhënat përkatëse për centralin fotovoltaik në lidhje me *orët e punës në një vit, numri i njësive gjeneruese, rendimentin* dhe *vitin e ndërtimit.*

Neni 9, pika 4.4.2: Shoqëria duhet të plotësojë të dhënat përkatëse teknike në lidhje me *prodhuesin e transformatorit, kapacitetin, gjatësinë e linjës* dhe kapacitetin transmetues.

Neni 9, pika 4.4.4, germa "b" : Shoqëria duhet të depozitojë në ERE grafikun e përditësuar, i cili parashikohet dhe në aneksin 2 të kontratës me MIE-n.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa "a", të ligjit "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, dhe nenit 5, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Meqenëse studimi i fizibilitetit për ndërtimin e impiantit fotovoltaik 2 mw parashikon se jetëgjatësia e burimit është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Erni Solar" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw për një afat 25-vjeçar**.**

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË
Nr. 18/8, datë 20.9.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Krijim hapësire rekreative në zonën e liqenit artificial të qytetit Ballsh"'.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Mallakastër.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, "Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Krijim hapësire rekreative në zonën e liqenit artificial të qytetit Ballsh"'.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këtë listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Mallakastër, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit 405,900 (katërqind e pesë mijë e nëntëqind) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahimi

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE PASURI E PALUJTSHME PRONË PRIVATE E TË CILËVE PREKET NGA PROJEKTI"KRIJIM HAPËSIRE REKREATIVE NË ZONËN E LIQENIT ARTIFICIAL TË QYTETIT BALLSH"

	PRONARI			TE DHENAT KADASTRALE					VLERSIMI PER SHPRONESIM				
									TOKE ARE			VLERA	
Nr	Emri	Atesia	Mbienri	Fshat/Qytet	Nr.Pas	ZK	Lloji I pasurise	Totale	Siperf e shpron (m2)	CMIMI (LEK/M2)	Vlera (leke)	Totale	Shenime
1	Dashnor	Adem	Malasi	Ballsh	30/40	1090	Are	1600	1600	123	196,800	196,800	Çmimi prej 123 leke/m2 është sygjeruar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me shkresen nr.3720/1 prot., date 15.07.2022, administruar prane Bashkise Mallakaster me nr. 3520/1 prot., date 19.07.2022
2	Veledin	Adem	Malasi	Ballsh	30/42	1090	Are	1700	1700	123	209,100	209,100	Çmimi prej 123 leke/m2 është sygjeruar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me shkresen nr.3720/1 prot., date 15.07.2022, administruar prane Bashkise Mallakaster me nr. 3520/1 prot., date 19.07.2022
TOTALI												405,900	

KËRKESË
Nr. 111/9, datë 20.9.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i hapësirave pranë kopshtit në fshatin Fushë, Njësia Administrative Topojë".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Fier.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për pasurinë e llojit "tokë truall", si dhe bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", për pasurinë e llojit "ndërtesë", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1 133 614 (një milion e njëqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e katërmbëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahimi

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARIT, PASURIA E TË CILIT PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIM I HAPËSIRAVE PRANË KOPSHTIT NË FSHATIN FUSHË, NJËSIA ADMINISTRATIVE TOPOJË, FIER"

Nr.	Emër Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e prekur ndërtesës (m²)	Amortizimi (%)	Vlera e ndërtesë me preventiv (lek)	Vlera e përgjith. (lek)	Gjendja juridike e pasurisë
1	Ramazan Ismail Hoxha	1655	73/20	142.41	60%	1.082.062	1.133.614	Konfirmim nga ZVRPP-ja më datë 8.11.2018, pajisur me certifikatë vërtetimi pronësie, datë 30.5.2005.
2	Shtet	1655	3 8/16	-	-	-		Konfirmim nga ASHK-ja, Drejtoria Fier, më datë 8.4.2022.
							1.133.614	

Vlerësimi është bërë duke zbatuar VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës se shpërblimit të pasurive pronë private, që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë për interes publik", dhe të VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

KËRKESË
Nr. 237/9, datë 21.9.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën "Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Rikualifikimi urban i lagjes 'Llukan Prifti"".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Kuçovë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për interes publik, "Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Rikualifikimi urban i lagjes "Llukan Prifti"".

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këtë listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Kuçovë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1,873,996 (një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahimi

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE TË TË CILËVE PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT 'RIKUALIFIKIMI URBAN I LAGJES 'LLUKAN PRIFTI''''

Nr.	PRONARI			TË DHËNA KADASTRALE										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM										SHËNIME (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
														ARË			TRUALL			NDËRTESË			VLERA TOTALE (lek)	
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m²)	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Sipërfaqja	Çmimi (lek/m³)	Vlera (lek)	Sipërfaqja	Çmimi (lek/m²)	Vlera(lek)		
	A	*B*	*C*	*C*	*Ç*	*D*	*E*	*F*	*G*	*H*	*I*	*J*	*K*	*L*	*M*	*N*	*O*	*P*	*Q*	*R*	*S*	*T*	*Y*	*Z*
1	**Thoma**	**Mihal**	**Gjergji**	Kuçovë	2310	8/382	**Godinë**	39		39	39						39	2,040	79,560	39		908,683	988,243	
2	**Eftion**	**Viron**	**Bishka**	Kuçovë	2310	8/369	**Godinë**	37		37	37						37	2,040	75,480	37		717,813	793,293	
3	Ismail	Rushit	Kapuçi	Polovinë	2179	99/52	Ullishtë	30				8	70	30	268	8,040							8,040	
4	Lili	Koçi	Çibuku	Polovinë	2179	99/44	Ullishte	100				7	69	100	268	26,800							26,800	
	Kristaq	Petraq	Çibuku																					
	Aleksandër	Nasi	Angjeliu																					
5	**Eduarte**	**Jani**	**Karamani**	Polovinë	2179	99/64	Ullishte	**291**				9	49	90	268	24,120							24,120	
6	Lili	Koçi	Çibuku	Polovinë	2179	99/24	Ullishte	125				7	22	125	268	33,500							33,500	
	Kristaq	Petraq	Çibuku																					
	Aleksandër	Nasi	Angjeliu																					
																							1,873,996	

KËRKESË
Nr. 369/8, datë 20.9.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesë, sipas VKT-së nr. 35 datë 13.9.2021, mbi disa përmirësime në projektpreventivin e objektit "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Rikualifikimi i akseve rrugore Unaza Lindore, loti II"'.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për pasuritë e llojit "arë" dhe "truall", ndërsa vlerësimi ndërtesës është llogaritur bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik, për pasuritë e llojit 'ndërtesë banimi ose jo banimi"', i ndryshuar.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 51 783 837.3 (pesëdhjetë e një milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tridhjetë e shtatë pikë tre) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahimi

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, SIPAS VKT-së NR. 35, DATË 13.9.2021, MBI DISA PËRMIRËSIME NË PROJEKTPREVENTIVIN E OBJEKTIT "PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT 'RIKUALIFIKIMI I AKSEVE RRUGORE UNAZA LINDORE, LOTI II"'

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas ZVRPP-së)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT E PASURISË									VLERA TOTALE (lek)	Konfirmimet	SHËNIME	Adresa
								Shpronësim tokë "arë"			Shpronësim tokë "truall"			Ndërtesë banimi (shtëpi)						
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pas.	Lloji i pas.	Sip. totale (m²)	Sip. (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Sip. (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Sip. ndërt. konf. ZVRPP (m²)	Çmimi mes. sh/blerjeve sipas ZVRPP (l/m²)	Vlera (lek)				
1	Syrja	Hysen	Sula	3976	234/124	Truall + ndërtesë	300			0	120	479	57480	**326.2**	61167	19952675.4	**20010155.4**	Konfirmuar nga ASHK-ja		**Tiranë, Shkozë rruga Nikollë Mekajshi**
2	Gezim	Selami	Collaku	3976	233/142	Are + truall + ndërtesë	383	174	448	77952	151	479	72329	**257.4**	61167	15744385.8	**15894666.8**	Konfirmuar nga ASHK-ja		**Tiranë, Shkozë**
3	Skënder Islam ISALLA	Lulzim Islam Isalla		3976	234/107	Truall + ndërtesë	300			0	225	479	107775	**236.3**	61167	14453762.1	**14561537.1**	Konfirmuar nga ASHK-ja		**Tiranë, Shkozë**
4	Muharem	Kalem	Lala	3976	233/229	Arë	1278	282	448	126336			0				**126336**	Konfirmuar nga ASHK-ja		**Tiranë, Shkozë**
5	Abaz	Alush	Rrahmani	3976	234/27	Arë	498	95	448	42560			0				**42560**	Konfirmuar nga ASHK-ja		**Tiranë, Shkozë**
6	Sefer Anila Saimir Engjellushe	Ramazan Sefer Sefer Sefer	Cinga Hoxha Cinga Shkalla	3976	236/28	Truall	500			0	26	**479**	12454				**12454**	Konfirmuar nga ASHK-ja		**Tiranë, Shkozë**
7	Hasan	Musa	Qordja	3550	170/2	Arë	10060	2299	448	1029952			0				**1029952**	Konfirmuar nga ASHK-ja	Ka dalë në VKM-në nr. 221, datë 13.4.2022, për sipërfaqen 542 m²	**Tiranë, Surrel**
8	Aleks	Jaho	Ymeri	3976	170/74	Arë	780.7	52	448	23296			0				**23296**	Konfirmuar nga ASHK-ja	Vendoset barrë hipotekare nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave Vendore Tiranë, shkresa nr. 123403, prot., datë 4.8.2016, ZVRPP nr. 26264, datë 8.8.2016	**Tirane**
9	Andrea	Hysen	Sula	3976	234/117	Arë	280	151	448	67648			0				**67648**	Konfirmuar nga ASHK-ja		**Tiranë, rruga "Idriz Dollaku"**
10	Andrea	Çaush	Shuli	3976	170/51	Arë	370	34	448	15232			0				**15232**	Konfirmuar nga ASHK-ja	Mbi këtë pasuri pozicionohet 170/51-nd., vol. 19, f. 121 l. leg.	**Tiranë, rruga "Kostandin Shpataraku"**
Shuma																	**51783837.3**			

KËRKESË
Nr. 586/8, datë 20.9.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 534, datë 22.09.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor 'Ndërtim i rrugës Porto-Romano–Durrës, loti 3"'.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit "arë" dhe "truall" vlerësimi bëhet bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë". Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Autoritetin Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 12,193,309 (dymbëdhjetë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e treqind e nëntë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahimi

LISTA EMËRORE E PRONARËVE PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE PREKEN NGA DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 534, DATË 22.9.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR 'PORTO-ROMANO–DURRES, LOTI 3'"

VKM nr. 534, datë 22.9.2021											
NR. i VKM-së	PRONARI			Zona kad.	Numri i pasurisë	Sip. totale	Lloji i pas.	Sipërfaqe shpronësimi	Çmimi, lek/m²	Vlera (lek)	
	Emri	Atësia	Mbiemri								
8	Vivjana		Luca	8517	6/13	4000	are	927	420	389340	
27	Besnik	Xhavit	Tusha	8517	5/4	20000	are	7382	420	3100440	
28	Çezarina	Çezar	Larushi	8517	3/1	4000	are	876	420	367920	
30	Aldoch Farma sh.p.k.			8517	2/221	5000	truall	1821	3119	5679699	

Ndryshimet e VKM-së nr. 534, datë 22.9.2021												
Nr.	PRONARI			Zona kad.	Numri i pasurisë	Sip. totale	Lloji i pas.	Sipërfaqe shpronësimi	Çmimi lek/m²	Vlera (lek)	Shënime	Adresat
	Emri	Atësia	Mbiemri									
8	Vivjana		Luca	8517	6/13	4000	are	1017	420	427140	Konfirmuar nga ASHK	Spitallë–Durrës
27	Besnik	Xhavit	Tusha	8517	5/4	20000	are	0	420	0	Kufizuar nga ASHK	Spitallë–Durrës
28	Çezarina	Çezar	Larushi	8517	3/1	4000	are	143	420	60060	Konfirmuar nga ASHK	Spitallë–Durrës
30	Aldoch Farma sh.p.k.			8517	2/221	5000	truall	821	3119	2560699	Vihet në favor të Credins Bank	Tiranë
	Shtesa në VKM nr. 534, datë 22.9.2021											
1	Merita	Ramadan	DoÇi	8517	5/8	8000	are	6907	420	2900940	Konfirmuar nga ASHK-ja	Spitallë–Durrës
2	Hene		Xhani	8517	3/6	24000	are	7469	420	3136980	Konfirmuar nga ASHK-ja	Durres
	Etleva		Aliaj									
	Majlinda		Xhani									
	Altin		Xhani									
	Kastriot		Xhan									
3	Suzana	Abdyl	Gjuzi	8517	3/5	8000	are	1633	420	685860	Konfirmuar nga ASHK-ja	Spitallë–Durrës
4	Bajram		Alla	8517	3/15	14000	are	2783	420	1168860	Konfirmuar nga ASHK-ja	Spitallë–Durrës
5	Hatixhe	Besim	Papa	8517	3/3	4000	are	875	420	367500	Konfirmuar nga ASHK-ja	Spitallë–Durrës
6	Komuniteti Mysliman Shqiptar			8517	3/7	200	are	20	420	8400	Konfirmuar nga ASHK-ja	Durres
7	Dashnor		XhamuÇa	8517	3/13	3000	are	947	420	397740	Vihet në hipotekë në favor të Bankës Popullore, 2008. Hiqen nga hipoteka në vitin 2008.	Spitallë–Durrës
8	Dashnor		XhamuÇa	8517	3/12	5530	are	918	420	385560	Vihet në hipotekë në favor të Bankës Popullore, 2008. Hiqen nga hipoteka në vitin 2009.	Spitallë–Durrës
9	Aldoch Farma Sh.p.k			8517	2/220	1600	truall	30	3119	93570	Në favor të Bankës Credins, në vitet 2014–2019.	Tiranë
	Shuma									**12193309**		

KËRKESË
Nr. 680/5, datë 20.9.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për disa shtesa dhe ndryshime të vendimit nr. 587, datë 7.9.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Ndërtimi i hidrocentralit Grabova 2' mbi pellghun ujëmbledhës të përroit të Grabovës, degë e lumit të Devollit, në qarkun Elbasan".

Subjekti kërkues i këtij projekti është shoqëria koncesionare "H.K. HEC Grabova 2" sh.p.k.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen, sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për pasurinë e llojit "tokë arë", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 86,276.16 (tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëmbëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahimi

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 587, DATË 7.9.2022, "PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT 'NDËRTIMI I HIDROCENTRALIT 'GRABOVA 2'"' MBI PELLGUN UJËMBLEDHËS TË PËRROIT TË GRABOVËS DEGË E LUMIT TË DEVOLLIT, NË QARKUN E ELBASANIT

NR.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM									VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
														"ARË"			"TRUALL"			"NDËRTESË"			Vlerat e kultura bujqësore dhe drufrutorëve sipas procesverbalit të Drejtorisë së Bujqësisë			
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose Qyteti	Z. Kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja Totale	"Arë" (m2)	"Truall" (m2)	"Ndërtesë" (m2)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	Vlera e kulturës bujqësore (lekë)	Vlera e drufrutorëve (lekë)		
	A	B	C	Ç	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S	T	U	V	Y	Z
1	LULËZIM	SEFER	TAÇE	Gramsh	2413	33	Arë	1150	1150			3	63	167.85	174	29,205.90									29,205.90	KONFIRMUAR ASHK
2	SHTET			Gramsh	2413	34	Arë	11800	11800			3	157	74.38	174	12,942.12									12,942.12	KONFIRMUAR ASHK
3	SHTET			Gramsh	2413	273	Arë	4500	4500			4	5	253.61	174	44,128.14									44,128.14	KONFIRMUAR ASHK
	SHUMA															86,276.16			0			0			86,276.16	

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2022 - Numri: 126
Datë: 2022/09/23 13:36:36
21751f2d-8cb8-477c-8414-66e2504a5622

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë